

VENDIM
Nr.4, datë 2.2.2015

PËRFILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ROBERTO OIL” SHA, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5 pika 2; 8, 10/3 ; të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Roberto OIL” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Roberto OIL” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit, i paplotësuar.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht. (Mungon vërtetimi nga prokuroria, që drejtuesi i shoqërisë nuk është në proces penal dhe struktura e funksionimit administrativ të shoqërisë.)

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

Të dhënat specifike sipas tipit të licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike:

- Neni 9, pika 4/10, germa “a” e paplotësuar.

Mungon sasia e energjisë elektrike që parashikohet të tregtohet për pesë vitet e ardhshme.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b” e paplotësuar.

Mungon deklarimi i kapitalit financiar të vënë në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti.

- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Roberto OIL” sh.a., për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti